FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 113

Tiranë – E martë, 1 gusht 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 55/2023, datë 13.7.2023	Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera.....	11835
Dekret i Presidentit nr. 160, datë 27.7.2023	Për shpallje ligji.....	11840
Dekret i Presidentit nr. 148, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11840
Dekret i Presidentit nr. 149, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11841
Dekret i Presidentit nr. 150, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11841
Dekret i Presidentit nr. 151, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11841
Dekret i Presidentit nr. 152, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11842
Dekret i Presidentit nr. 153, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	11842
Dekret i Presidentit nr. 155, datë 26.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11842
Dekret i Presidentit nr. 156, datë 26.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11843
Dekret i Presidentit nr. 157, datë 26.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11843

Dekret i Presidentit nr. 158, datë 26.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	11843
Dekret i Presidentit nr. 159, datë 26.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	11844
Dekret i Presidentit nr. 162, datë 27.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	11844
Dekret i Presidentit nr. 163, datë 27.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	11844
Dekret i Presidentit nr. 164, datë 27.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	11845
Dekret i Presidentit nr. 165, datë 27.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	11845
Dekret i Presidentit nr. 166, datë 27.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	11845
Dekret i Presidentit nr. 167, datë 27.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	11846
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 26.7.2023	Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike	11846
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 26.7.2023	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes	11847
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 26.7.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'", i ndryshuar	11851
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 17, datë 14.7.2023	Mbi kushtet specifike dhe procedurat e detajuara për importin e materialeve në kontakt me ushqimin, enëve plastike të kuzhinës, poliamide dhe melamine, me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës dhe Hong Kongu	11853
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 18, datë 21.7.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 18, datë 9.11.2022, "Për aditivët ushqimorë të lejuar"	11856
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 414, datë 26.7.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial", i ndryshuar	11862

Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 430, datë 21.7.2023	Për delegim kompetencash.....	11862
Vendim i Këshillin të Lartë Gjyqësor nr. 445, datë 24.7.2023	Për miratimin e formularëve standard të regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse.....	11863
Urdhër i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 91, datë 25.7.2023	Për delegim të kompetencave.....	11882
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 11871, datë 26.7.2023	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Konfederatën Zvicerane.....	11882
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 285/13, datë 27.7.2023	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Studim-projektim, zgjerim i segmentit rrugor dalje Elbasan–Përrenjas–Qafë-Thanë"'	11882
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 522/11, datë 28.7.2023	Për disa shtesa në VKM-në nr. 332, datë 31.5.2023, "Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i aksit Thumanë–Vorë–Kashar"'.....	11887
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 550/5, datë 28.7.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 65, datë 8.2.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikualifikimi i akseve rrugore 'Unaza Lindore, loti II dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit"".....	11895
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Albert Xheleshi.....	11897

LIGJ
Nr. 55/2023

PËR MENAXHIMIN E GARANCIVE DHE KREDIVE SHTETËRORE TË PAKTHYERA

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe kthimin e garancive shtetërore të huas, si dhe kthimin e kredive shtetërore të pakthyera, të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror para privatizimit të tyre.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë ligj kanë kuptimin si më poshtë:

a) "Debitorët e bankës" do të vlerësohen si debitorë të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për të gjitha kreditë e transferuara prej saj, sipas këtij ligji. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera gëzon të drejtat që banka ka pasur mbi debitorin, duke përfshirë edhe ndryshimet që banka mund t'i ketë bërë me marrëveshje ndërmjet debitorit dhe asaj përpara datës kur kredia është transferuar në pronësi të Agjencisë;

b) "Garanci shtetërore", "nënhua dhe nënhuazim" dhe "skema të veçanta të garancive" kanë të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë;

c) "Kthimi i garancive, huave dhe nënhuave" është procesi i mbledhjes së detyrimeve të huamarrësve kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat për detyrimet që kanë lindur si rezultat i pagesës së garancive nga ministria përgjegjëse për financat dhe si rezultat i marrëdhënies së huadhënies dhe nënhuazimit të fondeve, duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve, proces i cili do t'u nënshtrohet rregullimeve të këtij ligji, pasi të jenë përmbushur parashikimet e marrëveshjeve specifike të garancisë;

ç) "Menaxhimi i garancive" është procesi administrativ që ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kritereve të huamarrjes së institucioneve financiare në zbatim të skemave të veçanta të garancive, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të emetuara nga ministria përgjegjëse për financat, konfirmimin për draftin e marrëveshjes së huas, vijimin e procedurave të nënshkrimit të kredisë, verifikimin e rasteve të pagesës së garancisë dhe administrimin e të dhënave të skemave të veçanta të garancive;

d) "Ministër" është ministri përgjegjës për financat;

dh) "Trajtimi i kredive" është procesi i kthimit të kredive të pakthyera, të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror para privatizimit të tyre, duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve;

e) "Trajtimi i portofolit të investimeve" është procesi i kthimit të detyrimeve të pakthyera të dhëna nga shoqëria INSIG sh.a., në kohën kur kapitali i saj ka qenë në zotërim të shtetit, si kredi për blerjen e banesave, duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore, deri në likuidimin total të detyrimeve;

ë) "Huamarrës" ka të njëjtin kuptim si kredimarrës në përputhje me legjislacionin në fuqi "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

KREU II
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA

Neni 3
Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera

1. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (në vijim "Agjencia") është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

2. Të ardhurat e përfituara sipas shkronjave "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 15 të këtij ligji derdhen në buxhetin e shtetit. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

3. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4
Funksionet e Agjencisë

1. Agjencia ka si funksion:

a) menaxhimin e skemave të veçanta të garancive të huas;

b) kthimin e garancive shtetërore të huas;

c) kthimin e huave dhe nënhuave të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;

ç) verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nënhuave, të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;

d) trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre;

dh)trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG sh.a., para privatizimit të saj.

2. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj sipas neneve 499–507 të Kodit Civil, neneve 510, 511, 609, 610 të Kodit të Procedurës Civile, legjislacionit në fuqi për falimentimin dhe barrët siguruese, si dhe këtij ligji.

Neni 5
Drejtori i përgjithshëm

1. Agjencia përfaqësohet nga drejtori i përgjithshëm. Drejtori emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

2. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të zotërojë diplomë të nivelit "Master i shkencave" apo të barasvlershme me të, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë në "Shkenca juridike ose ekonomike". Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;

c) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion si jurist ose ekonomist;

ç) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake të paktën 10 (dhjetë) vjetët e fundit para emërimit;

d) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

dh) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

e) të mos ketë konflikt interesi me detyrën në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

3. Drejtori i Përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

a) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen nga detyra.

4. Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet nga detyra kur:

a) konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi për të cilat ushtron veprimtarinë Agjencia;

b) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;

c) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

ç) nuk realizon objektivat e vendosur nga Agjencia.

KREU III
MENAXHIMI I SKEMAVE TË VEÇANTA TË GARANCIVE SHTETËRORE

Neni 6
Verifikimi i përmbushjes së kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare dhe konfirmimi i këtyre kontratave tip

1. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së garancisë sipas legjislacionit në fuqi për borxhin shtetëror, institucionet financiare të përfshira në këto skema dërgojnë kërkesë pranë Agjencisë për konfirmimin e tipave të kontratave të kredive bankare, që do të përdoren në këto raste.

2. Agjencia kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës nga institucioni financiar, duke verifikuar:

a) respektimin e limiteve vjetore dhe limiteve totale, që janë përcaktuar rast pas rasti në marrëveshjen e garancisë në skemat e veçanta të garancisë;

b) respektimin e normës së interesit dhe afatit të maturimit, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

c) përputhshmërinë e marrëveshjes së huas me kushtet dhe kriteret e marrëveshjes se garancisë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në rastin e konstatimit të mangësive, Agjencia, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, i kërkon institucionit financiar plotësimin e të metave.

4. Nëse nga verifikimi rezulton se tipat e kontratave të huave janë në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e garancisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, Agjencia konfirmon këto kontrata dhe bankat vijojnë me procedurat e tyre për kreditimin e huamarrësve, që do të financohen sipas skemave përkatëse të garancisë.

Neni 7
Administrimi i informacionit, dokumentacionit të skemave të veçanta të garancisë dhe detyrime të tjera në lidhje me këto skema

1. Për marrëveshjet e huas të nënshkruara nga institucionet financiare, pjesë e skemave të garancive përkatëse, Agjencia ka detyrë:

a) të mbajë, të arkivojë dhe të përditësojë të dhënat e garancive;

b) të mbledhë dhe të arkivojë të gjithë dokumentacionin dhe raportimet e huadhënësve, duke përfshirë:

i. kopjet e marrëveshjeve të huas dhe të marrëveshjeve të mirëkuptimit;

ii. raportimet e huadhënësve;

iii. dokumente të tjera që i konsideron të nevojshme.

c) të rakordojë çdo 3 (tre) muaj të dhënat me huadhënësit dhe ministrinë përgjegjëse për financat;

ç) të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ministrinë përgjegjëse për financat për ecurinë e skemave të garancisë.

2. Për skemat e veçanta të garancisë, Agjencia ka detyrë:

a) të monitorojë shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit, në kuadër të marrëveshjeve të garancisë me anë të kontrollit të dokumentacionit dhe me anë të verifikimeve të faturave dhe mandatpagesave të subjekteve;

b) të kryejë mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

3. Të dhënat sipas pikës 1 të këtij neni administrohen në Regjistrin për Kthimin e Garancive Shtetërore. Ky sistem krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

4. Rregullat për bashkëpunimin e Agjencisë me ministrinë përgjegjëse për financat për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, si dhe për mbajtjen e dokumentacionit dhe të të dhënave, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

KREU IV
PAGESA DHE KTHIMI I GARANCIVE SHTETËRORE TË HUAS DHE NËNHUAVE

Neni 8
Pagesa sipas skemave të veçanta të garancisë

1. Agjencia shqyrton kërkesat e huadhënësve për pagesën e garancisë sipas skemave të veçanta të garancisë.

2. Agjencia verifikon brenda 10 (dhjetë) ditëve plotësimin e kushteve për pagesën e garancisë me anë të mandatpagesave të lëshuara nga banka dhe, në rast se janë plotësuar, ia përcjell atë menjëherë ministrit përgjegjës për financat për të proceduar me pagesën brenda afateve kohore të përcaktuara në marrëveshjen e garancisë.

Neni 9
Procedura e kthimit të garancisë, huas dhe nënhuas

1. Me kryerjen e pagesës së garancisë apo skemave të veçanta të garancisë, sipas përcaktimeve në marrëveshjet specifike të garancisë ndaj institucionit huadhënës, sipas legjislacionit në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë, ministri përgjegjës për financat njofton Agjencinë për fillimin e procedurave për kthimin e garancisë shtetërore të huas.

2. Në rast se një huamarrës nuk shlyen detyrimet në masën dhe kohën e duhur kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat, ministri përgjegjës për financat njofton menjëherë Agjencinë për fillimin e procedurave për kthimin e huas apo nënhuas.

3. Me qëllim kthimin e garancive, huave dhe nënhuave, Agjencia:

a) ndjek shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit në kuadër të marrëveshjeve të garancisë sipas skemave përkatëse të garancisë dhe marrëveshjeve të lidhura me institucionet financiare, si dhe për detyrimet e pakthyera, që rrjedhin sipas marrëveshjeve të huas apo nënhuas me anë të verifikimit të mandatpagesave;

b) i drejtohet me kërkesë me shkrim institucionit financiar për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e qëllimit të shkronjës "a" të kësaj pike në rastin e skemave të veçanta të garancive dhe vetëm pasi institucioni financiar ka mbledhur/arkëtuar pjesën e detyrimit të pambuluar nga garancia;

c) kërkon nga shërbimi përmbarimor fillimin e procedurave të kthimit të detyrimeve për të cilat nga ministria përgjegjëse për financat, sipas skemës së garancisë, është paguar tërësisht kredia bankare, kundrejt personave fizikë apo juridikë, të cilët kanë detyrime në momentin e kalimit të afatit të maturimit për shlyerjen vullnetare të detyrimit;

ç) kërkon nga organet gjyqësore fillimin e procedurave të falimentimit ose likuidimit kundrejt personave fizikë apo juridikë, të cilët kanë detyrime sipas parashikimeve të ligjit për falimentimin;

d) ka të drejtë të shesë sendet e luajtshme ose të paluajtshme, të kaluara në pronësi të Agjencisë, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për ankandin publik;

dh) pas procedurës përmbarimore, ka të drejtë të kalojë si kapital të vetë asetet e marra sipas shkronjave "b" dhe "c" të kësaj pike.

4. Nëse kthimi i detyrimeve në marrëveshjen e garancisë është parashikuar të realizohet nga institucioni financiar, kthimi i detyrimeve do të realizohet nga ky i fundit sipas parashikimeve të marrëveshjes specifike të garancisë.

Neni 10
Të drejtat e Agjencisë

1. Me qëllim kthimin e detyrimeve, Agjencia ka të drejtë:

a) të gëzojë të drejtat që institucionet financiare kanë pasur për debitorin, sipas skemave të garancive në bazë të marrëveshjeve me institucionet financiare, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë, si dhe në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit për skemat specifike të garancisë;

b) të marrë në pronësi, me pëlqimin e saj, sendin e lënë ose jo si kolateral, garanci apo dorëzani, kundrejt vlerës së ankandit të fundit të zhvilluar nga përmbaruesi gjyqësor në përputhje me nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë rast Agjencia zbret nga detyrimi vlerën e sendit sipas shumës së kontabilizuar;

c) të pranojë pagesën nga debitorët ose nga ndonjë person tjetër të të gjithë ose të një pjese të detyrimit për pjesën e detyrimit të paguar (garancisë së paguar) nga ministria përgjegjëse për financat.

2. Procedura e detajuar për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive të marra sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11
Identifikimi i pasurive të debitorëve

1. Për të identifikuar pasuritë e debitorëve, Agjencia kërkon informacion sipas legjislacionit të posaçëm pranë:

a) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;

b) Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve;

c) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

ç) institucioneve financiare;

d) institucioneve financiare jobankare;

dh) institucioneve të mikrofinancës.

2. Agjencia mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim informacioni me institucionet sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 12
Raportimi në regjistrin e kredive të Bankës së Shqipërisë

1. Agjencia raporton te regjistri i kredive dhe zbaton kriteret e klasifikimit për bankat dhe institucionet financiare jobankare, në mënyrë që këto hua/kredi/detyrime të figurojnë në regjistrin e kredive edhe pasi t'i transferohen Agjencisë, me qëllim që informacioni në regjistrin e kredive për këta huamarrës të jetë i plotë.

2. Mënyra dhe periodiciteti i raportimit sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

Neni 13
Përfundimi i garancisë

1. Garancia shtetërore e huas përfundon kur:

a) huaja për të cilën është dhënë garancia është shlyer tërësisht nga huamarrësi;

b) afati i garancisë, siç specifikohet në marrëveshjen e garancisë, ka kaluar;

c) pagesa i është bërë institucionit huadhënës në përputhje me afatet e garancisë.

2. Agjencia konstaton brenda 10 (dhjetë) ditëve përfundimin e garancisë në rastet e skemave të veçanta të garancisë me anë të verifikimit të mandatpagesave dhe dokumentacionit të Agjencisë dhe njofton menjëherë ministrin përgjegjës për financat.

Neni 14
Ndalesat

Agjencia ndalohet t'u kalojë institucioneve financiare bankare ose jobankare të drejtat e saj për mbledhjen e detyrimeve, të cilat janë bërë të kërkueshme dhe që nuk janë ekzekutuar ende nga debitorët, për të cilat është ngarkuar nga ky ligj, përjashtimisht kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet specifike të lidhura me institucionet financiare.

Neni 15
Trajtimi i kredive

1. Për kreditë, sipas përkufizimeve të shkronjave "dh" dhe "e" të nenit 2 të këtij ligji, e kaluara pranë Agjencisë në bazë të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar, Agjencia realizon procedurat e kthimit të detyrimeve duke ezauruar rrugët gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total.

2. Për kreditë, sipas përkufizimeve të shkronjave "dh" dhe "e" të nenit 2 të këtij ligji, të cilat janë dhënë nga bankat e nivelit të dytë dhe shoqëria INSIG sh.a., të kaluara pranë Agjencisë pa dokumentacionin ligjor, që vërteton marrjen e kredisë, procesverbali i transferimit të detyrimit kontabël dhe ligjor të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor.

3. Agjencia për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni vepron në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16
Dispozita me efekt ndryshues në akte të tjera

Pas shkronjës "g" të pikës 10 të nenit 4 të ligjit nr. 154/2020 "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare" shtohet shkronja "gj" me këtë përmbajtje: "gj) Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera.".

Neni 17
Dispozitë kalimtare

1. Kreditë, asetet, pasivet dhe kapitali i Agjencisë së Trajtimit të Kredive, të marra prej saj sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar, me hyrjen në fuqi të këtij ligji i kalojnë në pronësi kësaj Agjencie.

2. Personeli i Agjencisë së krijuar sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar, i transferohet Agjencisë.

3. Agjencia vijon të organizohet dhe të funksionojë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për

Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar, deri në ristrukturimin e saj sipas nenit 3 të këtij ligji, i cili përfundon brenda datës 1.1.2024.

4. Ministria përgjegjëse për financat merr masat, sipas legjislacionin në fuqi, për ristrukturimin e Agjencisë dhe përfshirjen e saj në buxhetin e vitit 2024.

Neni 18
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore sipas nenit 3, pika 3; nenit 7, pika 3, dhe nenit 10, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji.

3. Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të këtij ligji, vijojnë të zbatohen aktet nënligjore sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar.

Neni 19
Shfuqizime

Ligji nr. 8894, datë 14.5.2002, "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.7.2023.

Shpallur me dekretin nr.160, datë 27.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 160, datë 27.7.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 55/2023, "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 148, datë 25.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Majla Zenel Zeneli
2. Enea Michal Marcin Poprawski
3. Linda Arben Agolli
4. Kreshnik Simon Tanku
5. Liam Kreshnik Tanku
6. Lukas Kreshnik Tanku
7. Tea Bledar Elezi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 149, datë 25.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Ilmi Zenel Molla
2. Jonathan Ilmi Molla
3. Ilirjan Xhemil Arvaniti
4. Marina Ilirjan Arvaniti
5. Mario Ilirjan Arvaniti
6. Alex Ilirjan Arvaniti
7. Edisela Prekë Thaçi (Gjoka)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 150, datë 25.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Perparim Osman Elezaj
2. Rexhina Ramazan Radomi (Baba)
3. Eleonor Jani Radomi
4. Nertila Josif Mija (Bishka)
5. Kleon Bashkim Mija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 151, datë 25.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Gerta Pellumb Marku (Guri)
2. Ardit Ymerli Buzi
3. Andi Agron Bejleri
4. Ino David Nikolla
5. Genta Agron Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 152, datë 25.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93, të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Alba Gjovalin Susaj
2. Ervin Qemal Kosova
3. Bore Dede Susaj (Pjetërnikaj)
4. Hindenburg Qazim Leka
5. Jani Sotir Guri
6. Doriana Jordan Devole

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 153, datë 25.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Gjergji Maliq Bajramllari
2. Kristian Zef Mula
3. Dritan Maksim Tare
4. Neritan Petrit Mustafaraj
5. Fatjon Uani Gjeçi
6. Marina Maksim Tufi (Muka)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 155, datë 26.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit të mëposhtëm:
Gazmend Halil Gutaj.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 156, datë 26.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Laureta Ismet Nezaj Zeqa
2. Milazim Memet Susuri
3. Bukurije Sali Gërmizaj
4. Dijamanta Mazllum Raça

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 157, datë 26.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Arjanit Ram Muhametaj
2. Ramush Reshit Badalli
3. Agim Rasim Maçi
4. Dion Bekim Bardhi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 158, datë 26.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Driton Veli Pulaj
2. Alketa Haki Rexha
3. Enes Nexhat Badalli
4. Driton Sahit Buqa
5. Blerta Ramiz Dana (Kuksi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 159, datë 26.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Valon Pelivan Hoxhaj
2. Amet Nexhat Badalli
3. Alb Esat Muhaxhiri
4. Labinot Bahri Nezaj
5. Elmaz Nusret Kuksi (Shporta)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 162, datë 27.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1 Alime Xhemali Omaj (Ajazaj)
2. Arianit Salajdin Ademaj
3. Blerina Eshref Sylejmani (Qovanaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 163, datë 27.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93, të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Fausta Mikel Prela
2. Klarida Lutfi Lajthia (Xhaferi)
3. Ambra Tomorr Qekaçi
4. Denisa Ramadan Daja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 164, datë 27.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Klelia Luan Kamani
2. Vasil Millo Matanović
3. Xhelal Petrit Vladi
4. Jon Ruzhdi Kasa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 165, datë 27.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:
1. Hanushe Altin Omeri
2. Edmira Myzafer Altunay (Isufi)
3. Samanda Besnik Mokrëri (Idrizi)
4. Marilda Maksim Mançka
5. Lavduri Asqeri Liçenji (Çelaj)
6. Dielli Inli Liçenji

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 166, datë 27.7.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:
1. Marsela Bashkim Koçi (Driza)
2. Klea Llazar Miftari (Zoga)
3. Artan Gjovalin Prendi
4. Alida Muharrem Röhrig (Muka)
5. Maringlen Lek Toma

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 167, datë 27.7.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Aida Bekim Krasniqi (Shijaku)
2. Bardhyl Metush Grezda

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 469, datë 26.7.2023

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PËRGJITHSHME TË KREDIVE TË REJA PËR KATEGORITË PRIORITARE TË TË PUNËSUARVE PËRFITUES NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 64/3 e 64/5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të kredive të lehtësuara për administratën publike për vitin 2023 janë 300, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:
   a) 100 për mjekët e sistemit shëndetësor publik;
   b) 100 për punonjësit e Policisë së Shtetit;
   c) 100 për ushtarakët e Forcave të Armatosura.
2. Për kategoritë e përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi, përfituesit janë familjet e reja, të krijuara si rezultat i martesës së lidhur përpara nëpunësit të gjendjes civile, që përzgjidhen në bazë të sistemit të pikëzimit, të përcaktuar në tabelën 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. *Për kategorinë e përcaktuar në shkronjën "a",* të pikës 1, të këtij vendimi, përfituesit përzgjidhen në bazë të sistemit të pikëzimit**,** të përcaktuar në tabelën 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, përzgjedhja e tyre do të realizohet sipas sistemit të pikëzimit, të përcaktuar nga vetë institucioni përfitues.
5. Punonjësit e administratës publike përfitues përfitojnë kredi me interes 0%.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Tabela nr. 1

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	**KUSHTET E STREHIMIT**	**50**
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë ngelur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	
Ç	Familjet që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	

D	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	
1.2	**KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE/PUNËSIMI**	**50**
A	Të kenë pagën më të ulët sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave	
B	Punonjësit, sipas shkronjave "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij vendimi të cilët, në momentin e aplikimit, kanë jo më pak se dy vite të punësuar në administratën publikë.	

Tabela nr. 2

	KRITERET E PIKËZIMIT	**100 pikë**
1.1	**KUSHTET E STREHIMIT**	**50**
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë ngelur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	
Ç	Familjet që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	
D	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	
1.2	**Vetëdeklarim që është i angazhuar në institucionin shëndetësor publik, në një ose më shumë kategoritë e mëposhtme:**	**50**
A	Mjek i punësuar në sistemin shëndetësor publik, që ka nënshkruar marrëveshjen me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universitetin e Mjekësisë së Tiranës dhe ushtron profesionin pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve për "Mjekësi të Përgjithshme" në sistemin shëndetësor publik me kontratë pune sipas legjislacionit në fuqi.	
B	Mjek i punësuar në sistemin shëndetësor publik, që ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ushtrimin e profesionit pas përfundimit të ciklit të specializimit në shërbimin spitalor me kontratë pune sipas legjislacionit në fuqi.	
C	Mjek me kontratë pune sipas legjislacionit në fuqi në sistemin shëndetësor publik, që punon mbi 80 km larg vendbanimit ose në zona rurale apo qendra sekondare apo terciare.	
Ç	Mjek i punësuar në institucionet shëndetësore publike me kontratë pune me afat të pacaktuar.	

VENDIM
Nr. 472, datë 26.7.2023

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË INOVACIONIT TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes (në vijim "Qendra"), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit të Mbrojtjes (në vijim "ministri"), me seli në Tiranë.

2. Qendra financohet, pa u kufizuar, në burimet e mëposhtme:

a) buxheti i shtetit;

b) të ardhura të tjera të ligjshme në formën e granteve, donacioneve, projekteve të përbashkëta me aktorë të tjerë vendës apo të huaj, si dhe të ardhura të gjeneruara nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për të tretë, sipas marrëveshjes përkatëse;

c) fonde nga persona fizikë e juridikë, publikë ose privatë.

3. Qendra ka për mision nxitjen e inovacionit dhe të të gjitha proceseve të lidhura me të nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve, teknologjisë dhe projekteve që i përkasin fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.

KREU II
PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS

1. Qendra ka këto përgjegjësi:

a) zhvillimin e iniciativave dhe projekteve inovative me rëndësi strategjike për zhvillimin e

kapaciteteve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, sipas projekteve të përbashkëta dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me persona fizikë e juridikë, publikë ose privatë, si dhe partnerë të ndryshëm për zhvillim, vendës dhe ndërkombëtarë të kësaj fushe;

b) realizimin e testimeve dhe eksperimenteve për aplikimin e teknologjive të reja, produkteve industriale dhe shërbimeve me rëndësi strategjike, të përcaktuara për përdorim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe raporton për gjetjet tek autoritetet përkatëse;

ç) mbështetjen e kërkimit, zhvillimit, komercializimit që i avancon idetë e reja të sipërmarrjes në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në faza të ndryshme zhvillimi përmes ofrimit të aksesit te mentorët, këshilltarët, trajnimet, kapitali dhe burimet;

d) ndërveprimin me ministrin përgjegjës për sipërmarrjen në masat, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e ekosistemit të *startup*-eve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;

dh) mbështetjen e të gjithë atyre individëve që dëshirojnë të eksplorojnë ose të ndjekin një rrugë sipërmarrëse që në fazat e hershme të atij procesi, në fushën e mbrojtjes civile, sigurisë kibernetike, sistemeve të sigurta që mbështesin institucionet e sigurisë kombëtare për integrimin e sistemeve etj.;

e) nxitjen e projekteve të paraqitura prej strukturave të Forcave të Armatosura, institucioneve të arsimit të lartë, personave fizikë dhe juridikë, vendës dhe ndërkombëtarë, që kanë për objekt të veprimtarisë inovacionin në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane, që lidhen me fushën e sigurisë dhe mbrojtjes;

ë) dhënien e kontributit kryesor në nxitjen e inovacionit dhe rritjen e eficiencës në procese dhe mjete të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe sistemit të sigurisë në tërësi;

f) dhënien e kontributit në rritjen e sigurisë kibernetike dhe performancës së sistemeve të Forcave të Armatosura, sipas standardeve të NATO-s;

g) dhënien e kontributit në përmirësimin nëpërmjet inovacionit të shërbimit të komunikimit, monitorimit, zbulimit apo planifikimit në strukturat e sigurisë në vend;

gj) dhënien e kontributit në fuqizimin e kapaciteteve të përpunimit dhe analizës së imazherisë satelitore, fotogrametrisë dhe gjeodezisë;

h) bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë kombëtare sektoriale në fushën e shkencës dhe inovacionit, për sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes;

i) nxitjen e bashkëpunimit me sektorin e biznesit në fushën e teknologjisë e inovacionit për sigurinë e mbrojtjen dhe mbështetjen ndaj iniciativave të tij në këtë fushë.

2. Për nevoja të realizimit të veprimtarisë së saj, Qendra shkëmben informacion me:

a) institucione në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes;

b) institucionet e arsimit të lartë, qendra dhe institucione kërkimore-shkencore në vend;

c) NATO-n dhe partnerë të tjerë për zhvillim;

ç) persona fizikë e juridikë, publikë ose privatë, vendës apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor, inovacionit, komunikimeve elektronike dhe teknologjisë së informacionit etj.;

d) ministrinë përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike.

KREU III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS

1. Qendra drejtohet nga drejtori, i cili është titullari i institucionit dhe përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me të tretët. Drejtori ka këto kompetenca kryesore:

a) drejton, koordinon dhe monitoron veprimtarinë e Qendrës;

b) paraqet pranë ministrit, për miratim, aktet e brendshme që lidhen me veprimtarinë e Qendrës;

c) nënshkruan kontratat e financimit me aplikantët fitues, në kuadër të thirrjeve të hapura që realizohen nga Qendra. Përcaktimi i procedurave të thirrjeve të hapura dhe kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët do të përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes;

ç) bashkëpunon me agjencitë homologe në vende të tjera, nëpërmjet vendosjes së kontakteve, nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit për shkëmbim të eksperiencave dypalëshe;

d) informon ministrin e Mbrojtjes dhe bordin këshillimor për veprimtarinë e Qendrës, sa herë i kërkohet;

dh) i jep informacione, rekomandime e sugjerime Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të tjera, lidhur me aspektet e politikave dhe strategjive sektoriale në fushën e inovacionit për sigurinë dhe mbrojtjen;

e) miraton raportin vjetor të veprimtarisë financiare të Qendrës;

ë) miraton programet zhvillimore të Qendrës;

f) i propozon ministrit projektbuxhetin dhe mënyrën e shpërndarjes e të administrimit të të ardhurave të Qendrës;

g) i propozon ministrit projektstrukturën organizative dhe përshkrimet e punës së stafit të Qendrës;

gj) i propozon ministrit fushat prioritare të teknologjisë dhe inovacionit për sigurinë dhe mbrojtjen, sipas sugjerimeve të bordit këshillimor.

2. Kompetencat e detajuara të drejtorit përcaktohen në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës.

3. Drejtori i Qendrës emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga ministri. Drejtori emërohet për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Drejtori për emërimin në detyrë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave" apo "Master profesional", të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë për shkenca ekonomike/juridike/teknologji informacioni dhe komunikimi/inxhinieri elektronike/informatike/telekomunikacioni/matematikë-informatikë;

ç) të ketë përvojë në profesion, të paktën 8 (tetë) vjet;

d) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;

dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

5. Drejtori lirohet nga detyra, kur:

a) plotëson moshën për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

ç) jep dorëheqjen nga detyra;

d) konstatohet performancë e dobët;

dh) konstatohet në kushtet e ndalimit për kryerjen e funksioneve publike, sipas legjislacionit për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

6. Drejtori shkarkohet nga detyra:

a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) kur me veprimet e kryera gjendet në një situatë të konfliktit të interesit;

c) në rastet e mospërmbushjes së rëndë të detyrave;

ç) kur në mënyrë të përsëritur nuk respekton afatet e caktuara për përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;

d) në rastet e moszbatimit haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;

dh) kur braktis punën ose mungon në punë në mënyrë të pajustifikuar dhe të vijueshme për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune e më shumë.

7. Pranë Qendrës ngrihet bordi këshillimor, i cili funksionon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", dhe rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës.

8. Bordi këshillimor ka këto kompetenca kryesore:

a) përcakton linjën kryesore të veprimtarisë së Qendrës;

b) monitoron veprimtarinë ekonomiko-financiare të Qendrës;

c) i propozon drejtorit fushat prioritare të teknologjisë dhe inovacionit për sigurinë dhe mbrojtjen.

9. Kompetencat e detajuara të bordit këshillimor përcaktohen në rregulloren për metodat e

brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës.

10. Bordi këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Tre anëtarë përfaqësojnë Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e saj të varësisë dhe dy anëtarë të tjerë janë ekspertë nga sektori i biznesit, fusha akademike ose fusha të tjera që lidhen me veprimtarinë e Qendrës. Anëtarët e bordit këshillimor udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë, në raport me Qendrën.

11. Anëtarët e bordit këshillimor emërohen dhe shkarkohen nga ministri. Anëtarët e bordit këshillimor, të cilët nuk janë përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të saj të varësisë, duhet të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën e kërkimit-shkencor ose teknologjisë, ose inovacionit.

12. Anëtarët e bordit këshillimor emërohen për një mandat trevjeçar, me të drejtë riemërimi për një mandat të dytë radhazi.

13. Anëtarët e bordit këshillimor shkarkohen nga detyra, në rastet kur:

a) veprojnë në kundërshtim me parimin e mirëbesimit;

b) dënohen për kryerjen e një vepre penale me një vendim gjykate të formës së prerë;

c) mungojnë në detyrë pa shkak për 3 (tri) mbledhje radhazi;

ç) bëhen të paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë për një periudhë mbi 6 (gjashtë) muaj.

14. Kryetari i bordit zgjidhet ndërmjet anëtarëve të bordit këshillimor, është një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe emërohet nga ministri.

15. Kryetari dhe anëtarët e bordit këshillimor të Qendrës, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen nga buxheti i Qendrës, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.

16. Marrëdhëniet e punës së punonjësve civilë të Qendrës rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, ndërsa marrëdhëniet e punës së personelit ushtarak të Qendrës rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

17. Struktura dhe organika e Qendrës miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

18. Qendra funksionon sipas rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit, e cila propozohet nga drejtori dhe miratohet me urdhër të ministrit.

19. Qendra ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e Qendrës përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

20. Vula e Qendrës ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 17, datë 26.7.2023

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 10.6.2021, "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT E TË EMËRIMIT TË MËSUESIT NË NJË VEND TË LIRË PUNE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PËR ADMINISTRIMIN E PORTALIT 'MËSUES PËR SHQIPËRINË'", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Titulli i udhëzimit të ndryshohet si më poshtë:

"*Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë*".

2. Në secilin rast që përmendet udhëzimi nr. 30, datë 12.9.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar" të zëvendësohet me togfjalëshin "*udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin që përcakton numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar".*

3. Pika 1 e kreut 1 ndryshon si më poshtë:

"1. *Ky udhëzim rregullon procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit dhe të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë".".*

4. Në pikën 2 të kreut 1, pas fjalës "*mësues*" shtohen fjalët "*apo mësues në dispozicion*".

5. Pikat 5, 6, 7, 9 dhe 10 të kreut 1, ndryshohen si më poshtë:

"*5. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (në vazhdim DPAP) është përgjegjëse për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesit në një vend të lirë pune në sistemin e arsimit parauniversitar, ndërsa drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (në vazhdim DRAP) organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.*

6. DRAP-et, bazuar në të dhënat e dërguara nga ZVAP-et, shpallin vendet e lira të punës për lëvizjet paralele jo më vonë se 1 muaj para fillimit të vitit shkollor dhe gjatë vitit menjëherë nga njoftimi për vendin e lirë të punës. DRAP-et njoftojnë DPAP-në brenda 2 (dy) ditëve pune për vendet e shpallura.

7. Vendet e lira të punës në përfundim të vitit shkollor, shpallen pasi janë sistemuar mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore (lëvizje e detyruar paralele) dhe pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele me dëshirë, deri në 10 (dhjetë) ditë para fillimit të vitit mësimor.

9. ZVAP-të dërgojnë në DRAP 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të vitit shkollor listën e mësuesve të punësuar me procedurën e lëvizjes paralele dhe e publikojnë atë në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik. DRAP e publikon këtë listë në faqen elektronike zyrtare të saj dhe e dërgon në DPAP, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të vitit shkollor.

10. DRAP publikon në faqen elektronike zyrtare të institucionit listën me vendet e lira, provizore, me ngarkesë të plotë ose me të pjesshme, për vitin shkollor në vijim, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para fillimit të vitit shkollor dhe e dërgon në DPAP brenda 1 (një) ditë pune.".

6. Pika 4/1 e kreu 2, ndryshohet si më poshtë:

"4/1 Mësuesi nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se:

a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarave për Krime Seksuale; ose

b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.".

7. Në kreun 2, pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*6/1. Kandidati i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit, që zotëron më shumë se një licencë, ka të drejtë të aplikojë dhe të regjistrohet online në portalin "Mësues për Shqipërinë", për profilet e mësuesisë sipas licencave që zotëron.".*

8. Në kreun 2, pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*9/1 Në momentin e aplikimit kandidati që dëshiron të punësohet si mësues në dispozicion zgjedh opsionin "Pranoj të punësohem si mësues në dispozicion*".

9. Në kreun 2, në pikën 13 në fund shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

"*Mësuesit që kanë zgjedhur edhe opsionin mësues në dispozicion, renditen në një listë të veçantë sipas profileve për mësues në dispozicion në ZVAP-të ku kanë aplikuar.*".

10. Në pikën 4 të kreut 3 pas shkronjës b shtohet shkronja b/1 dhe pas shkronjës "c" shtohet shkronja "d", me përmbajtje si më poshtë:

"*b/1 zbaton funksionalitetin që bën renditjen e kandidatëve për mësues në dispozicion sipas përzgjedhjes së opsionit "mësues në dispozicion" dhe pikëve totale (shuma e pikëve të dosjes dhe e pikëve të testimit) për kandidatët për çdo ZVAP dhe për çdo profil.*

d) RASH heq nga lista e renditjes në portal vetëm për atë ZVAP, kandidatët që janë punësuar në vende pune vakant dhe me ngarkesë të plotë pas prodhimit të aktit të pranimit të vendit vakant të punës.".

11. Pika 3 e kreut 6 ndryshon si më poshtë:

"*3. ZVAP-të, në bashkëpunim me drejtoritë e IA-ve publike, identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen në IAP pas përfundimit të procesit të regjistrimit të nxënësve si dhe gjatë vitit shkollor.*".

12. Pika 5 e kreut 7 ndryshon si më poshtë:

"*5. Për mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtori i IAP-së dërgon në ZVAP listën emërore, dokumentacionin e njësuar me origjinalin dhe vlerësimin e dosjes, sipas shtojcës 2.1 të këtij udhëzimi brenda muajit gusht.*".

13. Në pikën 7 të kreut 7 fjalët "*brenda muajit korrik*" zëvendësohen me fjalët "*brenda muajit gusht*".

14. Në pikën 14 të kreut 7 fjalët "*krerëve 2, 4 dhe 8*", të zëvendësohen me fjalët "*krerëve 2, 4, 5 dhe 8*".

15. Në pikën 10 të kreut 8 fjalët "*në fund të çdo muaji*" të zëvendësohen me fjalët "*brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji*".

16. Pika 11 e kreut 8 ndryshon si më poshtë:

"*11. Çdo kandidat që ka përzgjedhur një vend pune me ngarkesë të plotë dhe është emëruar me kontratë pune pa afat, i ndryshon statusi në portal në statusin i punësuar dhe nuk qëndron më në renditjen e portalit "Mësues për Shqipërinë" për atë ZVAP.*".

17. Pas kreut 8, shtohet kreu 8/1 me përmbajtje si më poshtë:

"KREU 8/1
PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR MËSUESIT NË DISPOZICION

1. Kandidatët, të cilët dëshirojnë të punojnë si mësues në dispozicion në momentin e aplikimit, zgjedhin në portalin "Mësues për Shqipërinë" opsionin "Mësues në dispozicion". Në rastin kur kandidati zgjedh edhe opsionin "Mësues në dispozicion", plotëson shtojcën 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. ZVAP-ja para fillimit vitit të ri shkollor, bën rakordimin ndërmjet parashikimit të nevojave dhe numrit të miratuar të punonjësve të saj, për të planifikuar numrin e mësuesve në dispozicion sipas fushave/profileve.

3. ZVAP-ja, çdo fillim viti shkollor publikon listën e kandidatëve që kanë zgjedhur të punësohen si mësues në dispozicion, të cilët renditen sipas profileve për ZVAP-në ku kanë aplikuar.

4. Punësimi i mësuesve në dispozicion bëhet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (ZVAP-ja), sipas renditjes në portal.

5. Vendet e lira të punës, në pozicionin mësues në dispozicion, u ofrohen në fillim mësuesve që dalin pa ngarkesë mësimore dhe nuk janë sistemuar, sipas renditjes.

6. ZVAP-ja, sipas nevojave, emëron mësuesin, i cili nënshkruan kontratën e punës dhe pranon këtë pozicion pune. Kjo kontratë do të jetë deri në përfundim të vitit shkollor.

7. Mësuesi në dispozicion ka të drejtë të zgjidhë kontratën si mësues në dispozicion, nëse atij i ofrohet vendi i punës në profilin përkatës.

8. Mësuesi në dispozicion që ka nënshkruar kontratën, duhet të jetë i gatshëm në ZVAP çdo mëngjes për t'u punësuar sipas kërkesave që vijnë nga drejtuesit e IA-ve, për zëvendësim, rast pas rasti.

9. Mësuesi në dispozicion mund të plotësohet me orë në ditët e lira në veprimtari plotësuese, si: "Bëjmë detyrat e shtëpisë", SHQK etj., sipas nevojave të IAP-së.".

18. Pika 5 e kreut 9, ndryshon si më poshtë:

"5. Deri në plotësimin e vendit të lirë të punës nga lista e portalit të ZVAP-së, ose nga kandidatët e portalit nga të gjitha ZVAP-të në varësi të DRAP, bëhet punësimi me afat të caktuar me kandidatë të tjerë të profilit të përafërt në ZVAP dhe në mungesë të tyre me kandidatë të interesuar të këtij profili ose profili i përafërt, të cilët kanë paraqitur kërkesë në ZVAP, duke bërë renditjen e tyre. Lista e kandidatëve të kësaj kategorie bëhet publike në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së, dërgohet në DRAP, 5 ditë para fillimit të vitit shkollor. DRAP dërgon zyrtarisht në DPAP listën e kandidatëve të punësuar për këtë kategori 5 ditë pas fillimit të vitit shkollor dhe brenda 5 ditëve të para të çdo muaji, nëse gjatë vitit shkollor ka punësime të tilla.".

19. Pika 1 e kreut 10, ndryshon si më poshtë:

"1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, në rastet si më poshtë:

a) gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal;

b) mësuesi është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.".

20. Në kreun 12 pas pikës 4, shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*4/1 Përjashtimisht për punësimin e mësuesve në dispozicion për vitin shkollor 2023–2024, të gjithë mësuesve të renditur sipas profileve mund t'u ofrohet një vend pune si mësues në dispozicion krahas vendeve të lira apo vendeve të përkohshme të punës. Refuzimi i mësuesit për një vend pune si mësues në dispozicion, nuk përllogaritet për efekt të pikës 5 të kreut 8 të këtij udhëzimi.*".

21. Pas shtojcës 7 shtohet shtojca 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

22. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA 8

DEKLARATË
PËR ANGAZHIMIN SI MËSUES
NË DISPOZICION

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin "_____", të zhvilluar në vitin shkollor _____-_____, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se do të angazhohem të punojë si mësues në dispozicion në zyrat vendore të arsimit parauniversitar ku kam aplikuar, deri në ofrimin e vendit të punës në profilin përkatës.

DEKLARUESI

_____

UDHËZIM
Nr. 17, datë 14.7.2023

MBI KUSHTET SPECIFIKE DHE PROCEDURAT E DETAJUARA PËR IMPORTIN E MATERIALEVE NË KONTAKT ME USHQIMIN, ENËVE PLASTIKE TË KUZHINËS, POLIAMIDE DHE MELAMINE, ME ORIGJINË OSE TË DËRGUARA NGA REPUBLIKA POPULLORE E KINËS DHE HONG KONGU[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton kushtet specifike dhe procedurat e detajuara për importin e materialeve në kontakt me ushqimin, enëve plastike të kuzhinës, poliamide dhe melamine, me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës (në tekstin e mëtejshëm "Kina") dhe Rajoni i Posaçëm Administrativ i Hong Kongut të Republikës Popullore të Kinës (në tekstin në vazhdim "Hong Kong").

2. Për qëllime të këtij udhëzimi do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "enë plastike gatimi" nënkupton materiale plastike siç përshkruhen në udhëzimin nr. 12, datë 6.1.2017, "Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin", dhe që përfshihen në kodin CN ex 3924 10 00;

b) "dërgesë" nënkupton një sasi enë plastike kuzhine, poliamide ose melamine, mbuluar nga i njëjti dokument, të transportuara nga të njëjtat mjete transporti dhe që vijnë nga i njëjti vend i tretë;

c) "pika e parë e hyrjes" nënkupton pikën e hyrjes së një ngarkese në pikën e inspektimit kufitar;

ç) "kontroll dokumentar" nënkupton kontrollin e dokumenteve të përmendura në pikat 3 deri në 6 të këtij udhëzimi;

[1] Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me: Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 284/2011, të 22 marsit 2011, e cila përcakton kushte specifike dhe procedura të detajuara për importin e enëve të kuzhinës plastike poliamide dhe melamine me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës dhe Rajoni i Posaçëm Administrativ i Hong Kongut, Kinë.

d) "kontroll identiteti" nënkupton një inspektim vizual për të siguruar që dokumentet që shoqërojnë ngarkesën përputhen me përmbajtjen e ngarkesës;

dh) "kontroll fizik" nënkupton marrjen e mostrave për analiza dhe testime laboratorike dhe çdo kontroll tjetër të nevojshëm për të verifikuar përputhjen me kërkesat në lidhje me çlirimin e PAA-së (amine aromatike primare) dhe formaldehidit të përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 6.1.2017, "Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin".

3. Enë plastike gatimi poliamide dhe melamine me origjinë ose të dërguara nga Kina dhe Hong Kongu do të importohen vetëm nëse eksportuesi i paraqet AKU-së për çdo ngarkesë një deklaratë të plotësuar, në përputhje me çfarë kërkohet, duke konfirmuar se ngarkesa plotëson kërkesat në lidhje me lëshimin të aminave aromatike primare dhe formaldehidit, siç janë përcaktuar përkatësisht në shtojcën 2 dhe në shtojcën 1, të udhëzimit nr. 12, datë 6.1.2017, "Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin".

4. Modeli i deklaratës së përmendur në pikën 3 është paraqitur në shtojcën e këtij udhëzimi. Deklarata plotësohet në gjuhën shqipe, në gjuhën zyrtare të shtetit të Kinës dhe/ose në gjuhën angleze.

5. Deklarata e përmendur në pikën 3 shoqërohet nga një raport analizash laboratorike që siguron:

a) për sa u përket enëve poliamide të kuzhinës, rezultatet analitike të tregojnë se ato nuk çlirojnë në ushqime ose simulantë ushqimorë amina aromatike parësore në një sasi të dallueshme. Kufiri i zbulimit zbatohet për shumën e aminave aromatike primare. Për qëllimin e analizës është vendosur kufiri i zbulimit për aminat aromatike primare 0,01 mg/kg ushqim ose simulantë ushqimor;

b) për sa u përket enëve melamine të kuzhinës, rezultatet analitike të tregojnë se ato nuk çlirojnë në ushqime ose simulantë të ushqimit formaldehid në një sasi që kalon 15 mg/kg ushqim.

6. Inspektori i AKU-së dëshmon në deklaratën që shoqëron ngarkesën, nëse mallrat janë të pranueshme ose jo për t'u lëshuar në qarkullim të lirë, në varësi të faktit nëse ato përmbushin termat dhe kushtet e parashikuara në udhëzimin nr. 12, datë 6.1.201,7 "Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin", siç përcaktohet në pikën 3.

7. Importuesit ose përfaqësuesit e tyre duhet të njoftojnë inspektorin e AKU-së në PIK-un nga do të hyjë ngarkesa, të paktën dy ditë pune përpara datës dhe kohës së parashikuar të mbërritjes fizike të dërgesave me origjinë ose të dërguara nga Kina dhe Hong Kongu.

8. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në PIK kryen:

a) kontrolle dokumentare për të gjitha dërgesat nga momenti i mbërritjes së tyre;

b) kontrollet e identitetit dhe fizik, duke përfshirë analizimin laboratorik të 10% të ngarkesave dhe në mënyrë të tillë që të mos jetë e mundur për importuesit ose përfaqësuesit e tyre të parashikojnë nëse ndonjë ngarkesë e veçantë do t'u nënshtrohet kontrolleve të tilla; rezultatet e kontrolleve fizike duhet të jenë të disponueshme sa më shpejt që të jetë e mundur teknikisht.

9. Nëse analiza laboratorike e përmendur në germën "b", të pikës 8, identifikon mospërputhje, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të informojë menjëherë për rezultatet përmes Sistemit të Sinjalizimit të Shpejtë për Ushqimin dhe Ushqimin për Kafshë (RASFF).

9.1 Analizat e mostrave të marra kryhen në një laborator të akreditуar brenda dhe/ose jashtë vendit, deri në ngritjen e kapaciteteve laboratorike të ISUV-it.

10. Inspektori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në PIK mund të autorizojë transportin e mëtejshëm të ngarkesave me origjinë ose të dërguara nga Kina dhe Hong Kongu, në pritje të rezultateve të kontrolleve të përmendura në germën "b" të pikës 8.

11. Nëse inspektori në PIK jep autorizimin e përmendur në pikën 10, ai do të njoftojë DRAKU-në në pikën e destinacionit dhe do të japë një kopje të deklaratës së përcaktuar në shtojcë, të plotësuar siç parashikohet në pikat 3 deri në 6 të këtij udhëzimi, dhe rezultatet e kontrollet e përmendura në germën "b" të pikës 8, sapo këto të fundit të jenë të disponueshme.

12. DRAKU do të sigurojë që të vendosen masat e duhura për të garantuar që ngarkesat mbeten nën kontrollin e vazhdueshëm të tij dhe nuk mund të preken deri në pritje të rezultateve të kontrolleve të përmendura në germën "b" të pikës 8.

13. Lëshimi në qarkullim të lirë i enëve plastike të kuzhinës nga poliamidi dhe melamina me origjinë ose të dërguar nga Kina dhe Hong Kongu i nënshtrohet paraqitjes pranë autoriteteve doganore

të deklaratës së përcaktuar në shtojcë të plotësuar, siç parashikohet në pikat 3 deri në 6.

14. Kur kryhen kontrollet e përmendura në pikën 8, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit mban informacionin e mëposhtëm:

a) detajet e secilës ngarkesë të kontrolluar, duke përfshirë:

i. madhësinë për sa i përket numrit të artikujve;

ii. vendin e origjinës;

b) numrin e dërgesave që i nënshtrohen kampionimit dhe analizës;

c) rezultatet e kontrolleve të përmendura në pikat 8 dhe 9 të këtij udhëzimi.

15. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit i paraqet Ministrisë një raport që përfshin informacionin e përmendur në pikën 14, brenda datës 31 mars të çdo viti.

16. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon OBU-në për plotësimin e deklaratës për çdo ngarkesë të enëve plastike të gatimit, poliamide dhe melamine, me origjinë ose të dërguar nga Republika Popullore e Kinës dhe Rajoni i Posaçëm Administrativ i Hong Kongut, Kinë.

17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 30 shtator 2024.

MINISTËR I BUJQËSIA DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA
DEKLARATË QË DUHET DHËNË PËR ÇDO NGARKESË TË ENËVE PLASTIKE TË GATIMIT, POLIAMIDE DHE MELAMINE, ME ORIGJINË OSE TË DËRGUAR NGA REPUBLIKA POPULLORE E KINËS DHE RAJONI I POSAÇËM ADMINISTRATIV I HONG KONGUT, KINË

Emri dhe adresa e plotë (përfshirë nr. e telefonit ose *e-mail)* të personit fizik ose juridik që lëshon këtë deklaratë	
Emri dhe adresa e plotë (përfshirë nr. e telefonit ose *e-mail)* të operatorit/ve të biznesit që prodhojnë enët plastike të kuzhinës, të ngarkesës	
Emri dhe adresa e plotë (përfshirë nr. e telefonit ose *e-mail)* të operatorit të biznesit, i cili është përgjegjës për futjen në PIK të ngarkesës	

Kodi identifikues i ngarkesës:

Lloji dhe numri i artikujve në ngarkesë:

Kjo ngarkesë përmban enë gatimi plastike të bëra nga:

☐ Poliamidi - Janë kryer teste analitike që tregojnë se artikujt nuk çlirojnë PAA në një sasi të dallueshme

- Kufiri i zbulimit të metodës së përdorur është .....

- Rezultatet e këtyre testeve, si dhe përshkrimi i metodës së analizës së përdorur janë bashkëngjitur këtij dokumenti

☐ Melamine - Janë kryer teste analitike që tregojnë se artikujt nuk çlirojnë formaldehid në një sasi që tejkalon SML prej 15 mg/kg

- Rezultatet e këtyre testeve, si dhe përshkrimi i metodës së analizës së përdorur janë bashkëngjitur këtij dokumenti
Lista e dokumenteve të aneksuara që konfirmojnë se ngarkesa plotëson kërkesat në lidhje me çlirimin e amineve aromatike primare ose formaldehidit të përcaktuar në udhëzimin nr. 12, datë 6.1.2017, "Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin".

I nënshkruari, si importues i ngarkesës, konfirmon se një ngarkesë e tillë plotëson kërkesat në lidhje me çlirimin e amineve aromatike primare ose formaldehidit të përcaktuara në udhëzimin nr. 12, datë 6.1.2017, "Për materiale dhe artikuj plastikë të përcaktuar të jenë në kontakt me ushqimin".	Vendi dhe data Emri i nënshkruesit Nënshkrimi Adresa e plotë (duke përfshirë nr. e telefonit dhe *e-mail)*
Deklarata e autoritetit kompetent për ngarkesën	I pranueshëm për lëshim në qarkullim të lirë: Konform ☐ Jo konform ☐ Vendi dhe data Emri i nënshkruesit Nënshkrimi Adresa e plotë (duke përfshirë nr. e telefonit dhe *e-mail)*

UDHËZIM
Nr. 18, datë 21.7.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 9.11.2022, "PËR ADITIVËT USHQIMORË TË LEJUAR" [2]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në shtojcën 2, të udhëzimit nr. 18, datë 9.11.2022 "Për aditivët ushqimorë të lejuar", bëhen disa shtesa dhe ndryshime, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 janar 2024.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

[2] Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me: rregulloren (BE) nr. 1333/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, "Për aditivët ushqimorë", të amenduar deri më 1 mars 2023.

SHTOJCË

Në shtojcën 2 "Lista e aditivëve ushqimorë të miratuar për përdorim në ushqime dhe kushtet e përdorimit", të udhëzimit nr. 18, datë 9.11.2022, "Për aditivët ushqimorë të lejuar", bëhen shtesat dhe ndryshimet, me përmbajtje si më poshtë:

Në pjesën B:
Pika 2 "Ëmbëlsuesit", mbas E 960c shtohet si më poshtë:

'E 960d	Glucosylated steviol glycosides' (Glikozide stevioli të glukoziluar);

Pika 3 "Aditivë të tjerë nga ngjyruesit dhe ëmbëlsuesit", aditivi i mëposhtëm futet pas aditivit ushqimor E 1209:

'E 1210	Carbomer'

Në pjesën C, (5) "Aditivë të tjerë që mund të rregullohen përmes kombinimit", pika (v) zëvendësohet me sa vijon:
'(v) E 960a – 960d: glycoside stevioli

Numri E	Emri
E 960a	Glikozide stevioli nga Stevia
E 960c	Glikozide stevioli të prodhuara në mënyrë enzimatike
E 960d	Glikozide stevioli të glukoziluar';

Pjesa E është ndryshuar si më poshtë:
Në kategorinë 01.4 (Produkte qumështi të fermentuar të aromatizuar duke përfshirë produktet e trajtuara termikisht), E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	100	(1) (60)	vetëm produkte me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar';

Në kategorinë 03 (Akuj të ngrënshëm), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozidet e steviolit	200	(1) (60)	vetëm në produkte me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar'

Në kategorinë 04.2.2 (Fruta dhe perime në uthull, vaj ose shëllirë), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozidet e steviolit	100	(1) (60)	vetëm për konservat e fermentuara të frutave dhe perimeve";

Në kategorinë 04.2.4.1 (Përgatitjet e frutave dhe perimeve me përjashtim të kompostos), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozidet e steviolit	200	(1) (60)	vetëm për produkte me energji të reduktuar";

Në kategorinë 04.2.5.1 (Reçeli dhe pelte shtesë siç përcaktohet në urdhrin nr. 417, datë 26.9.2008, "Për miratimin e rregullores "Për recelin e frutave, xhelet, marmaladat dhe purene e gjeshtenjave për konsum njerëzor"), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glycosidet e Steviolit	200	(1) (60)	vetëm pelte, marmelata dhe reçel me energji të reduktuar;

Në kategorinë 04.2.5.2 (Reçel, pelte dhe marmelata dhe pure gështenjash të ëmbëlsuar siç përcaktohet në urdhrin nr. 417, datë 26.9.2008 "Për miratimin e rregullores 'Për reçelin e frutave, xhelet, marmaladat dhe purenë e gështenjave për konsum njerëzor'"), shënimi për E 960a – 960c (glikozide Stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glycosidet e steviolit	200	(1) (60)	vetëm pelte, marmelata dhe reçel me energji të reduktuar;

Në kategorinë 04.2.5.3 (Përhapje të tjera të ngjashme me fruta ose perime), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Steviol glycosides	200	(1) (60)	vetëm për produkte të shpërhapshme frutash ose perimesh me energji të reduktuar dhe produkte të thara me bazë frutash për shpërhapje në formë sanduiçi me energji të reduktur ose pa sheqer të shtuar

Në kategorinë 05.1 (Produktet e kakaos dhe çokollatës siç mbulohen nga urdhri nr. 257, datë 11.6.2008, "Për miratimin e rregullave 'Për produktet e kakaos dhe çokollatës'"), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	270	(1) (60)	vetëm për produktet me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar'

Në kategorinë 05.2 (Ëmbëlsirat e tjera duke përfshirë mikroëmbëlsirat freskuese të frymëmarrjes), shënimet për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohen me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	270	(1) (60)	vetëm me bazë kakao ose fruta të thata, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	330	(1) (60)	vetëm kakao, qumësht, fruta të thata ose sanduiç me bazë yndyre, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	350	(1) (60)	vetëm ëmbëlsira pa sheqer të shtuar, vetëm ëmbëlsira të forta me energji të reduktuar (karamele dhe ëmbëlsira) vetëm ëmbëlsira të buta me energji të reduktuar (karamele përtypëse, çamçakëz frutash dhe produkte sheqeri me shkumë / marshmallo) vetëm jamball me energji të reduktuar vetëm nuga me energji të reduktuar vetëm marzipan me energji të reduktuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	2 000	(1) (60)	vetëm mikro-ëmbëlsirat freskuese, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	670	(1) (60)	vetëm pastile freskuese të fytit me aromë të fortë, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar';

Në kategorinë 05.3 (Çamçakëz), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	3300	(1) (60)	Vetëm pa sheqer të shtuar';

Në kategorinë 05.4 (Zbukurime, veshje dhe mbushje, përveç mbushjeve me bazë frutash të mbuluara nga kategoria 4.2.4), shënimet për E 960a – 960c (Glikozide stevioli) zëvendësohen me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	330	(1) (60)	vetëm ëmbëlsira pa sheqer të shtuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	270	(1) (60)	vetëm me bazë kakao ose fruta të thata, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar';

Në kategorinë 06.3 (drithëra për mëngjes), shënimi për E 960a – 960c (Glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	330	(1) (60)	vetëm drithërat e mëngjesit me përmbajtje fibrash më shumë se 15 %, dhe që përmbajnë të paktën 20 % krunde, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar;

Në kategorinë 07.2 (Produkte të tjera buke dhe ëmbëlsira), shënimi për E 960a – 960c (Glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	330	(1) (60)	vetëm shtresë e hollë vaferi

Në kategorinë 09.2 (peshk të përpunuar dhe produkte peshkimi, përfshirë molusqet dhe krustacet), shënimi për E 960a – 960c (Glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	200	(1) (60)	vetëm konserva të ëmbla në të tharta dhe gjysmë të konservuara të peshqve dhe marinada të peshkut, krustaceve dhe molusqeve;

Në kategorinë 11.4.1 (Ëmbëlsues tavoline në formë të lëngshme), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	Sasi e mjaftueshme	(1) (60)';	

Në kategorinë 11.4.2 (Ëmbëlsues tavoline në formë pluhuri), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	Sasi e mjaftueshme	(1) (60)';	

Në kategorinë 11.4.3 (Ëmbëlsues tavoline në tableta), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	Sasi e mjaftueshme	(1) (60)';	

Në kategorinë 12.4 (Mustardë), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	120	(1) (60)';	

Në kategorinë 12.5 (Supa dhe lëngje mishi), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	40	(1) (60)	vetëm supa me energji të reduktuar";

Në kategorinë 12.6 (Salcat), hyrjet për E 960a – 960c (glikozidet steviol) zëvendësohen me sa vijon:

	'E 960a – 960d	Glikozide stevioli	120	(1) (60)	përveç salcës së sojës (e fermentuar dhe e pafermentuar)
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	175	(1) (60)	Vetëm salcë soje (e fermentuar dhe e pafermentuar)';

Në kategorinë 13.2 (Ushqime dietike për qëllime të veçanta mjekësore të përcaktuara udhëzimin nr. 20, datë 22.11.2021 "Për ushqimin për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, ushqimin për qëllime të veçanta mjekësore dhe zëvendësuesit e dietës totale për kontrollin e peshës" (duke përjashtuar produktet nga kategoria ushqimore 13.1.5)), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	330	(1) (60)’;	

Në kategorinë 13.3 (Ushqime dietike për dieta të kontrollit të peshës që synojnë të zëvendësojnë marrjen totale ditore të ushqimit ose një vakt të veçantë (të gjithë ose një pjesë të dietës totale ditore), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet si në vijim:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	270	(1) (60)’;	

Në kategorinë 14.1.3 (nektarët e frutave siç përcaktohet nga urdhri nr. 444, datë 7.12.2007, “Për miratimin e rregullores ‘Për lengjet e frutave dhe produkteve të ngjashme me to”’ C dhe nektarët e perimeve dhe produkte të ngjashme), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	100	(1) (60)	Vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar'

Në kategorinë 14.1.4 (Pije të aromatizuara), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	80	(1) (60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar'

Në kategorinë 14.1.5.2 (Të tjera), shënimet për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohen me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	30	(1) (60) (93)	vetëm për kafe, çaj dhe pije me infuzion bimor, me energji të reduktuar ose pa sheqerna të shtuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	30	(1) (60) (93)	vetëm për kafe të çastit të aromatizuar dhe produkte kapuçino të çastit, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	20	(1) (60) (93)	vetëm pije me bazë malti dhe me shije çokollate/kapucino, me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar';

Në kategorinë 14.2.1 (Birrë dhe pije me bazë malti), shënimi për E 960 (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	70	(1) (60)	vetëm birrë pa alkool ose me përmbajtje alkooli jo më të madhe se 1,2 % vol.; 'Bière de table/Tafelbier/Birrë tavoline' (përmbajtja origjinale e bimëve më pak se 6 %) me përjashtim të 'Obergäriges Einfachbier'; birra me një aciditet minimal prej 30 mili-ekuivalente të shprehura si NaOH; Birra kafe të llojit ‘oud bruin’;

Në kategorinë 14.2.8 (Pije të tjera alkoolike duke përfshirë përzierjet e pijeve alkoolike me pije joalkoolike dhe pije alkoolike me më pak se 15 % alkool), shënimi për E 960a – 960c (glikozide Stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	150	(1)(60)’;	

Në kategorinë 15.1 (Snacks me bazë patate, drithëra, miell ose niseshte), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	20	(1) (60)’;	

Në kategorinë 15.2 (Arra të përpunuara), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	20	(1) (60)’;	

Në kategorinë 16 (Ëmbëlsirat me përjashtim të produkteve të mbuluara nga kategoritë 1, 3 dhe 4), shënimi për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohet me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	100	(1) (60)	vetëm me energji të reduktuar ose pa sheqer të shtuar'

Në kategorinë 17.1 (Suplementet ushqimore që shpërndahen në formë të ngurtë, duke përjashtuar suplementet ushqimore për foshnjat dhe fëmijët e vegjël), shënimet për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohen me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	670	(1) (60)	
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	1800	(1) (60)	vetëm për suplemente ushqimore në formë të përtypshme”;

Në kategorinë 17.2 (Suplementet ushqimore në formë të lëngshme, duke përjashtuar suplementet ushqimore për foshnjat dhe fëmijët e vegjël), shënimet për E 960a – 960c (glikozide stevioli) zëvendësohen me sa vijon:

	‘E 960a – 960d	Glikozide stevioli	200	(1) (60)	
	E 960a – 960d	Glikozide stevioli	1800	(1) (60)	vetëm për suplemente ushqimore në formë shurupi”.

Në kategorinë e ushqimit 09.1.1 “Peshku i papërpunuar”, shënimet e mëposhtme janë futur midis hyrjes për E 302 Askorbat kalciumi dhe hyrjes për E 315 Acidi eritorbik:

	‘E 300	Acid ascorbic	300 mg/kg	(96)	vetëm për peshk ton
	E 301	Ascorbat natriumi	300 mg/kg	(96)	vetëm për peshk ton
	E 302	Ascorbate calcium	300 mg/kg	(96)	vetëm për peshk ton

(96): E 300, E 301 dhe E 302 janë të autorizuara veçmas ose të kombinuara, kufiri maksimal zbatohet për shumën e shprehur si acid askorbik';

Në kategorinë e ushqimit 09.2 “Peshk dhe produkte peshkimi të përpunuara, përfshirë molusqet dhe krustacet”, shënimet e mëposhtme futen midis hyrjes për nitratet E 251–252 dhe acidin eritorbik E 315:

	‘E 300	Acid ascorbic	300 mg/kg	(96)	vetëm ton
	E 301	Ascorbat natriumi	300 mg/kg	(96)	vetëm ton
	E 302	Ascorbate calcium	300 mg/kg	(96)	vetëm ton

(96): E 300, E 301 dhe E 302 janë të autorizuara veçmas ose të kombinuara, kufiri maksimal zbatohet për shumën e shprehur si acid askorbik';

Në kategorinë e ushqimit 17.1 “Suplementet ushqimore që shpërndahen në formë të ngurtë, me përjashtim të suplementeve ushqimore për foshnjat dhe fëmijët e vegjël”, shënimi i mëposhtëm futet pas shënimit për aditivin ushqimor E 1209:

	‘E 1210	Carbomer	200 000’		

Në kategorinë e ushqimit 17.2 “Suplementet ushqimore në formë të lëngshme, me përjashtim të suplementeve ushqimore për foshnjat dhe fëmijët e vegjël”, shënimi i mëposhtëm futet pas shënimit për aditivin ushqimor E 969:

	‘E 1210	Carbomer	30 000’		

URDHËR
Nr. 414, datë 26.7.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020, TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 20 dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

a) Shkronja "a", e pikës 3, të kreut III ndryshohet, si vijon:

"*a) "Psikologu duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, ose ekuivalente me to në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, dhe pas vitit 2019, licencë në fushën e psikologjisë së edukimit të lëshuar nga Urdhri i Psikologut".*

b) Pika 7, e kreut IV, ndryshohet si vijon:

"7. *Për realizimin procedurave të konkurrimit dhe të shpalljes së listës të kandidatëve fitues, DRAP-i përkatës krijon një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga 2 (dy) përfaqësues nga MAS-i, nga 1 (një) përfaqësues nga DPAP-ja, 1 (një) përfaqësues nga njëra prej ZVAP-ve, 1 (një) përfaqësues nga DRAP-i".*

c) Pas kreut IV, shtohet kreu IV/1, me përmbajtje:

"*KREU IV/1*

1. Në përfundim të vitit shkollor procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga DRAP-ja, për punonjësit e SHPS që ushtrojnë profesionin në institucionet arsimore publike parauniversitare, brenda juridiksionit të zyrave vendore të arsimit parauniversitar.

2. Punonjësi i SHPS që dëshiron të kryejë lëvizje paralele në përfundim të vitit shkollor, dërgon me postë në DRAP kërkesën për lëvizje paralele.

3. Dorëzimi i dosjeve për lëvizje paralele bëhet sipas afateve të përcaktuara nga DPAP- ja.

4. DRAP-ja krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:

a) drejtuesi i DRAP-së (kryetar);

b) një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në DRAP (anëtar);

c) juristi i DRAP-së (anëtar).

5. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në DRAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës nr. 2 të urdhrit, brenda muajit korrik.

6. Komisioni i vlerësimit të dosjeve shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele sipas zyrave vendore dhe pikëve në rendin zbritës. Lista me renditjen e punonjësve të SHPS-së shpallet në faqen elektronike zyrtare të DRAP-së, e cila dërgon një kopje të listës në DPAP.

7. Punonjësi i renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës brenda ZVAP-së ku ka emërimin e përhershëm. Ai dërgon brenda 24 orëve me e-mail konfirmimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të mos konfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet punonjësit të listuar një rend më poshtë.

8. Pas përzgjedhjes së vendit të punës nga kandidati, DRAP-i përkatës nxjerr aktin e emërimit të kandidatit në institucionin arsimor parauniversitar të përzgjedhur prej tij dhe nënshkruan kontratën e punës me të".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 430, datë 21.7.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave

Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Enio Civici për datën 24.7.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

